

Protokollin për masat lehtësuese për rifillimin e punës në institucionet parashkollore në Kosovë

(Ky dokument duhet të publikohet në hapësira të dukshme të institucionit parashkollor në mënyrë që të jetë i qasshëm për të gjithë)

Institucionet parashkollore për edukimin e fëmijëve në moshën e hershme, janë unike në qasjen e tyre edukative dhe janë ndër të parat që po shqyrtohen dhe përgatiten për rihapje. Në shumë shtete, edukimi në distancë për edukimin parashkollor, nuk ka qenë i mundur, ndërsa në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), me ndihmën e Partnerëve si UNICEF-i dhe Save the Children me datë 15 prill 2020, ka lansuar platformën Edukimi në Distancë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç. Kjo platformë u krijua që t'u jemi pranë prindërve/kujdestarëve ligjor, edukatorëve, në realizimin e aktiviteteve ditore me fëmijët në kushte shtëpie. Përmbajtja e aktiviteteve të prezentuara në këtë platformë, synon zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve në moshën e hershme si dhe sjellë informata se si të flasim me fëmijët për Covid-19. Duke pasur parasysh rolin që kanë institucionet parashkollore për të mbështetur jo vetëm fëmijët, por edhe prindërit/kujdesarit ligjor për t'u rikthyer në punë, lehtësimi i masave të izolimit nënkupton gjithashtu se fëmijët e vegjël do të kenë nevojë urgjente për kujdes institucional, pasi prindërit/kujdestarët ligjor kthehen në vendet e tyre të punës.

MASHTI, në bashkëpunim me donatorët dhe me komunitetin shëndetësor e edukativ, ka hartuar protokollin për realizim të veprimtarisë edukative për të gjitha institucionet parashkollore, të cilave ato duhet t'u përmbahen, pa dallim.

Ky protokoll i masave u dërgohet për zbatim Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA), udhëheqësve të institucioneve parashkollore(IP), prindërve/kujdestarëve ligjor, edukatorëve dhe stafit të brendshëm të institucioneve parashkollore.

Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA-të), mbështesin institucionet parashkollore në krijimin e kushteve të nevojshme në përgjigje të këtyre masave, ndërsa MASHTI, përmes Inspektoratit të Arsimit, monitoron zbatimin e protokollit.

- ❖ Institucionet parashkollore, hartojnë planin e veprimit duke u mbështetur në masat e poshtë-shënuara.

Për drejtorët komunal të arsimit dhe udhëheqësit e institucioneve parashkollore

- ✓ Bashkëpunoni me prindërit/kujdestarët ligjor, për t'iu mundësuar fëmijëve një kalim të natyrshëm nga ambienti i shtëpisë në institucion parashkollor përmes lojës dhe një komunikimi të hapur dhe të vazhdueshëm.
- ✓ Hartoni marrëveshje ndërmjet prindërve/kujdestarëve ligjor të fëmijëve – për respektimin e zbatimit të masave të ndërmarra nga institucionet kompetente.
- ✓ Informoni prindërit/ kujdestarët ligjor për masat që po zbaton institucioni parashkollor, planin e veprimit dhe kërkoni bashkëpunim për raportim të secilit rast të COVID-19 që ndodh në familje.
- ✓ Informoni prindërit/ kujdestarët ligjor për rëndësinë e matjes së rregullt të temperaturës, si vetes ashtu edhe fëmijëve.
- ✓ Nëse dikush në shtëpi dyshohet se ka COVID-19, udhëzoni prindërit/ kujdestarët ligjor që ta mbajnë fëmijën në shtëpi dhe të informojnë institucionin parashkollor dhe institucionin shëndetësor (qendrën më të afërt të mjekësisë familjare).
- ✓ Informoni prindërit/ kujdestarët ligjor për mbajtjen e fëmijëve në shtëpi në rast të regjistrimit të temperaturave më të larta.
- ✓ Siguroni për IP-të termometer digjital për matjen e temperaturës së fëmijëve.
- ✓ Mbroni stafin edukativ dhe fëmijët që janë në rrezik të lartë për shkak të moshës ose kushteve themelore shëndetësore.
- ✓ Hartoni plane për të zëvendësuar edukatorët që mungojnë.
- ✓ Vazhdoni procesin edukativ në distancë për të mbështetur fëmijët që nuk kanë mundësi të ndjekin edukimin në IP.
- ✓ Merrni parasysh politikat dhe praktikat fleksibile për pushime, duke koordinuar këtë proces në marrëveshje me stafin.
- ✓ Qëndroni në kontakt të vazhdueshëm me stafin dhe njoftoni për rëndësinë e të qenit vigjilent.
- ✓ Bëni matjen e temperaturës për të gjithë stafin në fillim të orarit të punës, para kontaktit me fëmijët, proces ky që përsëritet edhe para largimit nga puna, çdo ditë.
- ✓ Verifikoni nëse punonjësit kanë vështirësi me frymëmarrje ose shenja të tjera të sëmundjes infektive.

- ✓ Stafi me temperaturë të rritur të trupit dhe simptoma të tjera të sëmundjes infektive nuk duhet të vijë në punë, të kujdesen për fëmijët ose të hyjnë në mjediset e institucionit.
- ✓ Krijoni procedura për të siguruar që fëmijët dhe stafi që vjen në institucion parashkollor, të sëmurë, ose që sëmuren gjatë qëndrimit aty, të dërgohen në shtëpi sa më shpejt që të jetë e mundur.
- ✓ Mbani fëmijët dhe stafin e sëmurë, të ndarë nga fëmijët dhe stafi jo i sëmurë, derisa ata të dërgohen në shtëpi apo në qendrën e mjekësisë familjare. Ndiqni udhëzimet e duhura kombëtare për këtë çështje.
- ✓ Mbani shënime për fëmijët që shfaqin temperaturë të lartë të trupit dhe për simptome tjera që manifestohen gjatë qëndrimit në institucion parashkollor, për të mbështetur gjurmimin e kontakteve në rast se konfirmohet infektimi me COVID-19.
- ✓ Përgatitni procedura të qarta të sjelljes dhe marrjes së fëmijëve në dhe nga institucioni parashkollor, që nuk krijojnë panik midis familjeve dhe fëmijëve; fëmijët kanë nevojë për siguri nga kujdestarët e tyre dhe edukatorët, pasi që kanë kaluar javë të tëra larg institucionit parashkollor.
- ✓ Udhëzoni punonjësit mbi detyrimin për të monitoruar shëndetin e tyre dhe gjendjen e fëmijëve dhe mbi respektimin e procedurave në përputhje me rekomandimet në lidhje me parandalimin e COVID-19 (duke përfshirë respektimin e distancës fizike dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale).
- ✓ Siguroni internet për të gjitha institucionet parashkollore, për ta mundësuar realizimin e përmbajtjes edukative të ofruar nga ana e MASHTI-t në Platformën “Edukimi në Distancë”.

Për stafin menaxherial/edukativ/teknik të institucionit parashkollor

- ✓ Mat temperaturën me termometër digjital të gjithë stafit dhe fëmijëve, çdo ditë.
- ✓ Udhëzon dhe përcjellë stafin dhe fëmijët që t’i pastrojnë duart me sapun për 20-30 sekonda sapo të hyjnë në IP.
- ✓ Krijoni një orar për higjienën e shpeshtë të duarve, si pjesë e rutinës së përditshme të fëmijëve dhe stafit, dhe siguroni dezinfektues të mjaftueshëm me bazë alkooli ose sapun dhe ujë të pastër në hyrjet e institucioneve parashkollore dhe në të gjitha mjediset parashkollore. Shqyrtoni vendosjen e posterëve vizuel nëpër grupe edukative, për t’iu përkujtuar fëmijëve dhe stafit mbajtjen e higjienës.

- ✓ Vëzhgon gjendjen shëndetësore të fëmijëve dhe stafit si dhe kryerjen e masave higjieno-sanitare prej tyre.
- ✓ Ofron mbështetje për stafin dhe edukatorët për trajnime specifike si dhe për mbështetje praktike për t'u kthyer në institucion parashkollor (nëse kjo është e nevojshme, kërkohet nga organet kompetente si DKA – të dhe MASHTI).
- ✓ Udhëzoni dhe mbështetni edukatorët dhe menaxhmentin për të dërguar komunikime të vazhdueshme pozitive tek prindërit/kujdestarët ligjor.
- ✓ Kontaktoni rregullisht me familjet rreth asaj se si po ndjehen ata dhe fëmijët e tyre.
- ✓ Zhvilloni mekanizma të referimit për familjet me nevoja të mbështetjes psikosociale (kontaktoni organet kompetente sipas nevojës).
- ✓ Ndërprisni opsionet e ofrimit të ushqimit në stilin e byfeve, dhe, nëse është e mundur, ofroni ushqimet në mënyrë individuale, pra në grupet e fëmijëve.
- ✓ Siguroni pajisjet e nevojshme për zbatimin e masave të përcaktuara nga IKSHP dhe MASHTI.
- ✓ Siguroni pajisje për të gjithë stafin me mjetet mbrojtëse, si: shampun për duar, maska, dorëza për një përdorim, dezinfektues të ambientit dhe dezinfektues për duar.
- ✓ Dezinfektoni lodrat, mjetetet didaktike dhe ambientet e secilit grup, çdo ditë.

“MASAT NDAJ COVID-19 QË DUHET TË NDËRMARRIN INSTITUCIONET PARASHKOLLORE”

1. Sjellja dhe marrja e fëmijëve nga institucioni parashkollor

- ✓ Orari për sjelljen dhe marrjen e fëmijëve në institucione parashkollore, rregullohet sipas një orari të hartuar nga drejtorët e institucionit parashkollor dhe të monitoruar nga edukatori/stafi i autorizuar nga IP-të, i cili vendoset në hyrje të çdo objekti.
- ✓ Drejtuesi i institucionit duhet të caktojë një person i cili në momentin kur fëmija pranohet në institucion, në baza ditore kryen këto veprime:
 - Fëmijëve dhe të gjithë stafit në hyrje të institucionit parashkollor, u mat temperaturën me termometër digjital.
 - Fëmijët dhe stafi që hyjnë në institucion vazhdojnë direkt për të pastruar duart me shampun për 20-30 sekonda.
- ✓ Prindërit/kujdestarët ligjor duhet të sjellin dhe marrin fëmijët duke respektuar me përpikmëri orarin e përcaktuar nga institucioni parashkollor.

- ✓ Rekomandohet që sjellja dhe marrja e fëmijëve nga çerdhja/kopështi të bëhet nga prindërit/kujdestari ligjor (për shkak të sigurisë nuk është e lejuar që fëmijët të sjellen apo merren nga gjyshërit).
- ✓ Fëmija shoqërohet nga njëri prind\kujdestari ligjor, i cili qëndron jashtë ambienteve të institucionit dhe pret në distancë 1.5 m nga personat e tjerë për ta dorëzuar fëmijën tek personeli, i cili është përcaktuar për pranim të fëmijëve në IP.
- ✓ Gjithmonë fëmija të pritët dhe shoqërohet brenda institucionit nga një edukatore e cila e merr fëmijën në hyrje të IP-ve.
- ✓ Rekomandohet të vendosen vaska me dezinfektues me bazë klori aktiv, për dezinfektimin e shuajve të këpucëve përpara hyrjes në ambientet e brendshme të IP-ve.
- ✓ Fëmijët lejohen të hyjnë dhe të dalin nga institucioni vetëm në mbërritje dhe në largim.
- ✓ **Vëmendje**, mjediset e institucionit parashkollor, nuk duhet të fillojnë të duken si spitale.
- ✓ Dera e institucionit do të qëndrojë e mbyllur gjatë kohës që fëmijët janë brenda, ndërsa dritaret e dhomave/sallave të hapen herë pas here për të lejuar ajrosjen e nevojshme brenda tyre. Ambienti duhet të jetë i ajrosur gjatë gjithë kohës.
- ✓ Në rast se fëmija shfaq temperaturë gjatë qëndrimit në shtëpi, prindi/kujdestari ligjor duhet të informojë menjëherë edukatoren dhe të mbajë fëmijën në shtëpi.
- ✓ Nëse fëmija shfaq temperaturë apo shenja të tjera të shëndetit jo të mirë gjatë qëndrimit në IP, njoftohet prindi\kujdestari ligjor, që të paraqitet për të marrë fëmijën sa më parë nga ambientet e institucionit parashkollor.
- ✓ Kur është e realizueshme, pjestarët e stafit duhet të mbajnë maska brenda institucionit. Maskat për fëmijët e vegjël nuk rekomandohet dhe, nën asnjë rrethanë, foshnjeve dhe fëmijëve nën moshën dy vjeç NUK duhet t'u vihen mbulesat e fytyrës nga pëlhura për shkak të rrezikut të ngufatjes.
- ✓ Institucioni parashkollor, duhet të caktojë një vend të veçantë për fëmijët që mund të kenë simptoma, derisa prindi/kujdestari ligjor nuk vjen për ta marrë fëmijën.

2. Strategjitë e distancimit fizik gjatë qëndrimit në institucion parashkollor

- ✓ Rekomandohet shfrytëzimi maksimal i ambienteve të institucionit, për të ruajtur distancimin fizik në grupet me numër të madh të fëmijëve.
- ✓ Fëmijët e një grupi duhet të qëndrojnë në të njëjtën sallë/dhomë çdo ditë dhe me të njëjtat edukatore (edukatorët e grupit).
- ✓ Gjatë kësaj periudhe, rekomandohet të mos kryhet asnjë aktivitet jashtë ambienteve të kopshtit (jashtë hapësirave të institucionit parashkollor).

- ✓ Gjatë procesit edukativ, edukatorët qëndrojnë duke respektuar distancën dhe rekomandohet të përpiqen t'i vendosin fëmijët në distancë nga njëri tjetri (p.sh. rreth një tavolinë me 10 karrige ulen 5 fëmijë).
- ✓ Të merren masat e nevojshme që fëmijët të mos ndihmojnë në përhapjen e transmetimit të virusit duke:
 - Mbajtur secilin grup fëmijësh në një dhomë/sallë të veçantë.
 - Kufizuar përzierjen e fëmijëve midis grupeve, në kohën që ata kryejnë aktivitete ditore në IP dhe në oborrin e IP-ve, drejtuesit, edukatorët hartojnë një orar sipas grupeve për shfrytëzimin me radhë të hapësirave të përbashkëta.
- ✓ Lojërat me njëri tjetrin, apo aktivitete të tjera, duhet të organizohen në mënyrë që të respektohet gjithmonë brenda mundësive distancimi fizik midis fëmijëve.
- ✓ Në kohën e gjumit të shfrytëzohet hapësira e dhomës maksimalisht duke i vendosur fëmijët larg nga njëri tjetrit (respektohet distancë fizike) .
- ✓ Mbulesat e gjumit të shenjëzohen me iniciale të secilit fëmijë, në mënyrë që të shmangët përdorimi i tyre nga fëmijët tjerë të grupit.
- ✓ Gjatë kësaj periudhe nuk lejohet organizimi i festave të ditëlindjeve dhe organizime festive në IP- të.

3. Kujdesi për higjienën në mjediset e institucionit parashkollor

- ✓ Institucionet parashkolore organizojnë aktivitete shtesë përmes të cilave fëmijët ndërgegjësohen për rëndësinë që ka distancimi fizik dhe higjiena personale në ambientet brenda dhe jashtë institucionit.
- ✓ Fëmijëve duhet t'u flitet në mënyrë të vazhdueshme përmes lojës lidhur me COVID-19, rregullat e higjienës, larjen e duarve, mënyrën e duhur të kollitjes dhe teshtitjes etj.
- ✓ Në ambientet e institucionit të vendosen postera mbi masat e parandalimit të infektimit me COVID-19, higjienën respiratore dhe atë personale si dhe rregullat për distancimin fizik, të dizenuara në mënyrë sa më të thjeshtë, të përgaditura nga ana e edukatoreve, në mënyrë që të jenë të kuptueshme nga fëmijët.
- ✓ IP-të sigurohen që ka ujë të rrjedhshëm, sapun të lëngët, letra për tharjen e duarve dhe dezinfektues me përmbajtje alkooli 60%, në ambientet e institucionit (kujdes fëmijët e vegjël futjen e dezinfektuesit në gojë).
- ✓ Ndërrimi i pelenës tek fëmijët e vegjël - Kur ndërrohet një fëmijë, më parë duhen larë duart, më pas duhen përdorur doreza për të vijuar me ndërrimin.
- ✓ Para pranimit të fëmijëve në institucion parashkollor, të kryhet dezinfektimi i çdo dhome, çdo hapësire të IP-ve. Po ashtu, pas largimit të fëmijëve, të kryhet pastrimi i sipërfaqeve dhe orendive me lëndë dezinfektuese për çdo ditë.

- ✓ Në fund të çdo dite duhet të kryhet edhe dezinfektimi i mjediseve të përbashkëta.

4. Pastrimi dhe dezinfektimi i lodrave

- ✓ Lodrat të cilat nuk mund të dezinfektohen largohen nga përdorimi.
- ✓ Lodrat apo objektet që futen në gojë dhe që janë të ndotur me sekrecione duhet të largohen dhe të mos përdoren deri sa të dezinfektohen.
- ✓ Lodrat prej materiali që mund të lahen në rrobalarëse /pastrim kimik duhet të përdoren vetëm nga një fëmijë dhe më pas të lahet, para se të mund të përdoret nga një fëmijë tjetër.
- ✓ Lodrat apo mjetet didaktike nuk duhet të kalohen nga një grup në tjetrin, pa i larë apo pa i dezinfektuar.
- ✓ Librat e fëmijëve, si dhe materialet e tjera me bazë letre, si letra, zarf, revista, dosje nuk konsiderohen se përbëjnë rrezik të lartë për transmetim dhe nuk kanë nevojë për procedura shtesë të pastrimit ose dezinfektimit (kujdes për foshnjat dhe fëmijët e vegjël).

5. Për edukatorët\et

- ✓ Edukatorja e grupit pranon fëmijën në hyrje të institucionit parashkollor, nga personi i autorizuar në IP, i caktuar në pranimin e fëmijëve.
- ✓ Gjatë kohës që edukatorja qëndron me fëmijët duhet të përpiqet të respektojë distancimin social, duke i orientuar ata në vendet ku duhet të qëndrojnë.
- ✓ Edukatorët e institucioneve parashkollore, vazhdojnë të punojnë me përmbajtjen e ofruar nga Platforma “Edukimi në distancë”, duke e shoqëruar atë me aktivitete shtesë të cilat organizohen nga ana e stafit edukativ, për të mundësuar një kthim të fëmijëve në institucion parashkollor të natyrshëm. Brenda mundësive zhvendosni realizimin e aktiviteteve në ambient të hapur sa më shumë që të jetë e mundur, nëse e lejon moti. Fëmijët e vegjël duan të jenë jashtë, dhe, për momentin, për ta është më e sigurt që të mësojnë jashtë sesa brenda (zhvillimi i kohës në rreth jashtë, mësimi për natyrën, etj.), duke pasuruar përvojat mësimore me aktivitetin fizik në natyrë (lojëra, vallëzim, sport, etj).
- ✓ Ndani fëmijët në grupe më të vogla, me nga 2-3 fëmijë, për të mbështetur bashkëveprimin midis fëmijëve duke kufizuar aktivitetet në grupe të mëdha.
- ✓ Përdorni praktikat pedagogjike kreative për të siguruar përvojat e këndshme të të mësuarit rreth situatës së pandemisë (për shembull, ndërtimi i mësimit bazuar në projekte mbi përvojën e fëmijëve me pandeminë; përdorimi i lojërave imagjinare për të ndihmuar fëmijët të përballen me stresin dhe për të promovuar qëndrueshmërinë; përdorimi i

momenteve të mësueshme për të ndihmuar fëmijët të mësojnë në lidhje me pandeminë dhe rolin e tyre në sigurimin e shëndetit publik).

- ✓ Balanconi aktivitetet e të nxënit individual me ndërveprime në grupe të vogla; përdorimi i kreativitetit për të përzier ndërveprimet individuale dhe në grup (për shembull, reflektimi/puna individuale, e pasuar nga "kthehu dhe tregoj fqinjt tuaj").
- ✓ Një mënyrë e mirë për të inkurajuar kreativitetin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e artit, pa qenë e nevojshme t'i ndani këto midis fëmijëve, është krijimi i kutive individuale për secilin fëmijë me markerë, gërshërë, ngjyra, që secili fëmijë të përdorë mjetet e veta.
- ✓ Përqendrohuni tek loja imagjinare, lojërat fizike që mund të respektojnë distancimin shoqëror, këndimi, projektet artistike individuale, etj.
- ✓ Lojërat dhe projektet ku secili fëmijë mund të kontribuojë individualisht (një nga një) do të funksionojë shkëlqyeshëm - d.m.th le ta bëjmë të gjithë një tregim si orë edukative, duke vazhduar me rend; fëmijët e bëjnë me rend ngjytjen e ndonjë vizatimi në muret e grupit etj.
- ✓ Mbështetuni në të lexuar interaktiv me zë të lartë dhe aktiviteteve argëtuese për tërë grupin, siç është shfaqja e kukullave nga edukatorja ose ndonjë këngë të re të cilën do të mund ta mësojnë të gjithë.
- ✓ Përdorni kukulla për të demonstruar simptomat (teshtitjen, kollitjen, ethet, kujdes kukullat duhet të jenë të dezinfektara paraprakisht), çfarë të bëjnë nëse ndihen të sëmurë (d.m.th. nëse ju dhemb koka, stomaku, nëse kanë temperaturë ose ndihen të lodhur).
- ✓ Zhvilloni një mënyrë për të përcjellur larjen e duarve dhe shpërbleni fëmijët për larjen e shpeshtë/me kohë të duarve (këndoni një këngë gjersa lani duart për të ushtruar kohëzgjatjen e rekomanduar prej 20 sekondave).
- ✓ Edukoret duhet t'i lajnë duart gjithmonë para përgatitjes së ushqimit si dhe pasi i ndihmojnë fëmijët për të ngrënë.

6. Për personelin ndihmës

- ✓ Drejtuesi i institucionit duhet të hartojë një protokoll me oraret për pastrimin dhe dezinfektimin e institucionit.
- ✓ Rekomandohet pastrimi rutinor i sipërfaqeve dhe objekteve të cilat preken më shpesh nga fëmijët, veçanërisht lodrat, karriget, tavolinat, kutitë e lodrave, etj.
- ✓ Pastrimi i këtyre objekteve nuk duhet kryer në prani të fëmijëve në dhomë/ambient.
- ✓ Korridoret dhe tualetet pastrohen dhe dezinfektohen rregullisht sipas një grafiku – ditor (mbahet evidenca e pastrimit).

- ✓ Sanitaret të mbajnë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat.
- ✓ Largimi nga institucioni bëhet pas përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit të çdo ambienti të tij.
- ✓ Kryhen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin social me fëmijët dhe edukatorët dhe stafin.
- ✓ Sigurohuni që mbeturinat të largohen çdo ditë, si dhe që hudhja e tyre të bëhet në mënyrë të duhur.

6. Përgatitja e ushqimit dhe shërbimi i tij - punonjësit e kuzhinës

- ✓ Zbatoni respektimin e legjislacionit kombëtar për sigurinë e ushqimit dhe parimet e higjienës së duhur dhe sigurisë së ushqimit nga ana e personave përgjegjës për ushqimet gjatë blerjes, dërgimit, ruajtjes, përgatitjes dhe shpërndarjes së shujtave (UA 03/2019 – për të ushqyerit e shëndetshëm të fëmijëve në institucionet edukative, arsimore, aftësuese të arsimit parauniversitar).
- ✓ Minimizoni rreziqet e kontaminimit. Kujtojuni fëmijëve të mos prekin ushqimin ose pijet e askujt tjetër dhe të mos e ndajnë ushqimin e tyre me askënd si dhe dekurajoni fëmijët nga ndarja e mjeteve, ushqimit, etj.
- ✓ Kufizoni personat e tjerë (për shembull, për pastrimin, riparimin ose sjelljen e ushqimit) që të hyjnë në hapësirën e shfrytëzuar për ngrënie për sa kohë që fëmijët janë aty.
- ✓ Personeli që përgatit ushqimin duhet të mbajë gjithmonë maskë.
- ✓ Personeli duhet të lajë gjithmonë duart para, gjatë dhe pas mbarimit të përgatitjes së ushqimit.
- ✓ Mjetet dhe sipërfaqet që përdoren për përgatitjen e ushqimit duhet të lahen para dhe pas përdorimit të tyre.
- ✓ Lavamanet që përdoren për larjen dhe përgatitjen e ushqimit nuk duhet të përdoren për asgjë tjetër.
- ✓ Stafit menaxherial në bashkëpunim me edukatorët e grupeve edukative, hartojnë plan për të ushqyerit e fëmijëve në grupe të vogla, duke respektuar distancë fizike.
- ✓ Mjedisi ku kryhet ushqyerja e fëmijëve duhet të pastrohet dhe dezinfektohet para dhe pas ngrënies së çdo grupi të fëmijëve.
- ✓ Edukatorët duhet të sigurohen që fëmijët t'i lajnë duart gjithmonë para dhe pas ngrënies, ose t'u pastrohen herë pas here (për fëmijët në IP).

- ✓ Pastroni dhe dezinfektoni sipërfaqet që preken shpesh, si dorezat e dyerve, tavolinat, lodrat, furnizimet, priza e dritave, kornizat e dyerve, pajisjet për lojëra, mjetet mësimore të përdorura nga fëmijët.

7. Për prindërit\kujdestarët ligjor

- ✓ Prindi/kujdestari ligjor, nënshkruan marrëveshjen me institucionin parashkollor për zbatimin e masave nga IP- të. Prindërit/kujdestarët ligjor, nuk do lejohen të futen në ambientet e brendshme dhe ata duhet të raportojnë nëse fëmijët kanë patur ose jo temperaturë në shtëpi, po ashtu fëmijëve do t'u matet temperatura sapo të mbërrijnë në çerdhe apo në kopsht.
- ✓ Në çdo rast që paraqiten shqetësime apo rritje të temperaturës, prindërit/kujdestarët ligjor duhet të paraqiten për të marrë fëmijët nga IP.
- ✓ Prindërit/kujdestarët ligjor duhet të sjellin dhe marrin fëmijët duke respektuar me përpikmëri orarin e përcaktuar nga institucioni parashkollor.
- ✓ Fëmija shoqërohet nga njëri prind/kujdestar ligjor, i cili qëndron jashtë ambienteve të institucionit dhe pret në distancë 1.5 m nga personat e tjerë për ta dorëzuar fëmijën tek personi i autorizuar për pranimin e fëmijës nga menaxhmenti i IP-ve, dhe e njejta rregull vlen edhe në marrjen e fëmijës nga IP.
- ✓ Në rast nevojë për komunikim me edukatoren apo drejtorin e IP-ve, përdoret vetëm komunikimi elektronik.
- ✓ Në rastet e shoqërimit të fëmijës në institucion, prindi/kujdestari ligjor nuk duhet të hyjë në mjediset e brendshme për asnjë arsye.
- ✓ Prindi/kujdestari ligjor duhet të deklarojë nëse ka patur kontakt me persona të prekur me COVID-19 në familje apo në ambientet e punës.

Përfundim:

Në rihapjen institucioneve parashkollore pas pandemisë së COVID-19, sfida më e gjerë për menaxherët e programeve, drejtorët, edukatorët dhe familjet, do të jetë puna e përbashkët që kemi përpara, *jo vetëm për të balancuar, por për të integruar* nevojën për respektim të udhëzimeve të përshtatura dhe të arsyeshme kombëtare të shëndetit publik përmes krijimit të një mjedisi të sigurt, të këndshëm, stimulues që promovon shëndetin fizik, sigurinë emocionale, lidhjet shoqërore dhe nxënien e angazhuar për fëmijët. Bashkëpunimi dhe komunikimi gjithëpërfshirës dhe i hershëm midis palëve, do të jetë kyç për zbatimin e masave të nevojshme. Do të jetë e rëndësishme ruajtja e fleksibilitetit dhe modifikimi i qasjeve sipas nevojës, si dhe sigurimi i nxënies dhe shkëmbimi i praktikave të mira.

MASHTI, është duke punuar ngusht me donatorët, në listimin e nevojave në ofrimin e mbështetjes dhënë komunave, DKA-ve dhe institucioneve parashkollore pa dallim, në nivel vendi, si në furnizimin me material dezinfektues për ruajtjen e shëndetit të fëmijëve, mbështje profesionale stafit menaxherial, edukativ dhe prindërve në menaxhimin e situates së krijuar në vend me Covid 19.